ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: POLICIA E KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i Prokurimit	214-25-2432-2-1-1

Sa i përket tenderit për: SHERBIMI ME BILETA PËR TRANSPORTIN AJROR PËR NEVOJAT E PK-SË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: AS Travel Club Sh.P.K

Adresa : Rr. Tringe Smajli Nr. 6, Prishtinë

Numri Telefonit: 044-158 544

Emri i plotë i përfaqësuesit (te autorizuarit) të kompanisë suaj: Flamur Bahtijari

Adresa elektronike: info@astravel-club.com

Data e parashtrimit të ankesës: 30.06.2025

Nënshkrimi dhe vula: _____

Travel Agency L.L.C. "AS TRAVEL CLUB" Prishtinë 1 Agencia Turistike

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për Kontrate:28.04.2025
2. Procesverbal i Hapjes se Tenderëve: 15.05.2025
3. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës: 10.06.2025
4. Kërkese për qasje ne Dokumentet e Tenderit:10.06.2025
5. Konfirmimi i Lejimit ne Qasje të dokumenteve të Tenderit: 11.06.2025;
6. Kërkese për Rishqyrtim: 16.06.2025
7. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 20.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	X	

Hapja e ofertave në mënyre elektronike me datën 15.05.2025 ora 14:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			Jo		

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës me datën **10.06.2025** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit Standard B 58- Njoftimi për Anulimin aktivitetit të prokurimit.

Këtij Vendimi ja ka bashkangjitur edhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	X	Jo	

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën **16.06.2025** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës.

Me datën **20.06.2025** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;

Shkeljet e dispozitave- RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP) janë:

Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 43- Ndërprerja e procedurave të prokurimit;

Neni 97 - Shkeljet e rënda- Anulimi i aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues - me datën **10.06.2025** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit Standard B 58- Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka marre vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Formularit Standard B 58- Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ja ka bashkangjitur:

Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të kompanisë tone, OE: AS Travel Club SH.P.K;
Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të OE: Altavia Travel Sh.p.k;
Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të OE: AIRVOYAGE SH.P.K;

Me datën **10.06.2025** kemi bere kërkese për qasje në dokumente e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, me datën **12.06.2025** në ora **10:00** Zyrtaret e Prokurimit të Autoritetit Kontraktues na kane lejuar qasje në dokumentet e tenderit (ofertën) e OE: AIRVOYAGE SH.P.K;

Me arsyetimin së OE: Altavia Travel Sh.p.k së bashku me ofertën ka dorëzuar **Aneksin 3- Kërkese për Konfidencialitet, qasjen ne ofertën e OE:** Altavia Travel Sh.p.k na e ka lejuar qasjen tek me datën: 13.06.2025 ne ora 13:30.

Me datën **16.06.2025** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës. Në ketë Kërkese për Rishqyrtim kemi shënuar të gjitha faktet dhe argumentet që dëshmojnë së AK-Policia e Kosovës, vlerësimin e ofertave dhe vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit e ka marre ne kundërshtim të plote me **nenin 7, 59 dhe 62 të LPP** dhe **nenit 40, 43 dhe 97 të Rregullores për Prokurimit Publik 002/2024.**

Më datën **20.06.2025**, përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim si të pa bazuar. Bazuar në ketë vendim shihet së Zyrtaret e AK fare nuk kane marre për baze faktet dhe argumentet tona të shënuara në Kërkesën tone për Rishqyrtim të datës **16.06.2025**.

Pretendimi 1: Shkelje e neni 7, nenit 59 dhe nenit 62 të LPP si dhe shkelje e neni 40, nenit 43 dhe nenit 97 paragrafi (k) të RRPP NR.002/2024

Bazuar në dokumentet që kemi shkarkuar nga Platforma e E-prokurimit dhe dokumentet që kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues, konsiderojmë së Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës gjate vlerësimit të ofertave dhe marrjes së vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit ka bere shkelje substanciale të nenit 7, nenit 59 dhe nenit 62 të LPP si dhe nenit 40 , nenit 43 dhe nenit 97 pargrafi (k) të RRPP 002/2024.

Faktet dhe argumentet së pse ne konsiderojmë kështu janë:

1. Autoriteti Kontraktues në Formularin B58 – në faqen 1 ka shënuar:
   " Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit në mungese të një oferte të përgjegjshme".

Ky konstatim i Autoritetit Kontraktues **nuk qëndron** për faktin së oferta e kompanisë tone AS TRAVEL CLUB SH.P.K i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga AK në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit dhe është oferta me çmimin më të lire.

Bazuar në ketë fakt Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur asnjë arsyeje të vetme që ta anuloj aktivitetin e prokurimit sa i për ketë mungesës së një oferte të përgjegjshme.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues në Formularin B58 – në faqen 1 ka shënuar:

2. Duke u bazuar ne nenin 62,Pika 1.1 të LPP një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit".

Ky konstatim i Autoritetit Kontraktues **nuk qëndron** për faktin së gjate fazës së zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit deri të faza e vlerësimit të ofertave nuk ka ndodhur asnjë shkelje e ligjit aktual e cila nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit dhe në ketë rast asnjë dispozite e këtij ligji nuk kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Çmimi i planifikuar prej **500.00 €** për një bilete, nuk ka shkaktuar asnjë shkelje të ligjit aktual të prokurimit, për faktin së çmimi i biletës gjate realizimit të kontratës është i ndryshueshëm dhe gjënerohet nga sistemi

kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILEO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo çmimet momentale në web faqet e avio kompanive kur behet rezervimi i biletës plus tarifa e shërbimit (service charge) **sipas shumës fikse të ofruar nga kontraktuesi e paraqitur në numrin rendor 2 të Listës së Çmimeve, që në rastin konkret tarifa e shërbimit (service charge) ne ofertën e kompanisë ton AS TRAVEL CLUB SH.P.K është 0.01 €.** Pra shume mire shihet së nuk ka ndodhur asnjë shkelje që nuk mund të riparohet gjate realizimit të kontratës për faktin së e vemja e dhëne që nuk mund të ndryshohet gjate realizimit të kontratës është tarifa e shërbimit (service charge) që siç cekem me larte ne rstin konkret është 0.01 €. Të gjitha te dhënat tjera që kane qene të shënuara në Dosje të Tenderit, Listën e Çmimeve dhe ofertën tone mund të ndryshon gjate realizimit të kontratës. Bazuar ne këto të dhëna të shënuara në këto dokumente shihet së gjate realizimit të kontratës mund të ndryshohet vlera e kontratës që sipas ofertës tone është 700,014.00 €, mund të ndryshohet sasia e biletave dhe gjithashtu mun të ndryshohen çmimet e biletave.

Prandaj bazuar në këto fakte dhe argumente, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur asnjë baze të vetme ligjore që për shkak së gjeja të shkeljeve ligjore ta beje anulimin e aktivitetit të prokurimit pasi që siç cekem me larte asnjë shkelje që nuk mund të riparohet nuk ka ndodhur.

3. Autoriteti Kontraktues në Formularin B58 – gjithashtu në faqen 1 dhe vazhdim në faqe 2 ka shënuar: " Komisioni i vlerësimit konstaton se për ketë aktivitet te prokurimit janë pranuar tri(3) oferta . Komisioni i vlerësimit ka vërejtur se specifikat teknike në fazën e përgatitjes së specifikimeve teknike janë disa mangësi , po ashtu gjate përgatitjes se listës se çmimeve është lëshuar një gabim kur te çmim për njësi është vendosur çmimi 500 euro ku ne realitet ka qene 495 nga ky gabim ka rezultuar së te gjitha ofertat kane tejkaluar vlerën e parashikuar për ketë projekt, nga ky lëshim asnjë nga OE nuk mund të trajtohet ne mënyre të barabartë, andaj komision i vlerësimit kane kërkuar të anulohet aktiviteti".

Edhe ky konstatim i Autoritetit Kontraktues – komisionit të vlerësimit të ofertave nuk qëndron për faktin së komisioni i vlerësimit të ofertave është i obliguar që vlerësimin e ofertave ta beje **sipas kritereve të kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate duke përfshi edhe specifikat teknike të paraqitura në Aneksin nr. 1 të Dosjes së Tenderit,** e jo komisioni të merret me **specifika teknike të imagjinuara të cilat nuk kane qene pjese e Dosjes së Tenderit.** Bazuar në legjislacionin e prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, përgjegjës për hartimin e specifikave teknike janë zyrtaret e Njësisë së Kërkesës, që në rastin konkret për ketë aktivitet të prokurimit kane hartuar specifika teknike shume profesionale dhe gjithëpërfshirëse dhe janë specifikat teknike me profesionale pothuajse nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese që kane publikuar tenderët e tyre për shërbime të transportit ajror.

Bazuar në këto fakte, komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka pasur asnjë baze të vetme ligjore që për shkak të specifikave teknike të rekomandoj anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Gjithashtu konstatimi i komisionit të vlerësimit të ofertave sa i për ketë Listës së Çmimeve nuk qëndron për faktin së komisioni i vlerësimit të ofertave është i obliguar që vlerësimin e ofertave ta beje sipas Listës se Çmimeve që e ka hartuar Njësia e Kërkesës dhe e cila është publikuar së bashku me Dosjen e Tenderit në Platformën e E-Prokurimit e jo komisioni të merret me Listën e Çmimeve të imagjinuar së gjeja në " realitet paska qene 495.00 Euro". Bazuar në legjislacionin e prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, përgjegjës për hartimin e Listës së Çmimeve janë zyrtaret e Njësisë së Kërkesës, që në rastin konkret për ketë aktivitet të prokurimit kane hartuar Listën e Çmimeve dhe në ketë liste kane shënuar:

Sasia e përafërt për 36 muaj, 1400 cope dhe çmimin e planifikuar për një bilete prej 500.00 €.

Gjithashtu në Listën e Çmimeve ka shënuar:
***Vlera e biletës prej 500 euro është një vlerë që shërben vetëm për kalkulim të çmimit dhe çmimi total do të përdorët vetëm për nevojat e vlerësimit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës pasi që çmimet janë variabël dhe kontrata do të bazohet në sasinë e biletave.**

Të njëjta të dhëna Autoriteti Kontraktues sipas kërkesës së Njësisë së Kërkesës i ka shënuar edhe në Aneksin nr. 1- Specifikat Teknike të Detyrueshme ku në faqen nr. 18 të DT ka shënuar:

Gjatë periudhës tri vjeçare numri i përafërt i biletave do të jetë 1400, në destinacione të ndryshme të botës. Kontrata konsiderohet e realizuar në bazë të sasive të biletave dhe jo vlerës së biletave.

Në faqen nr. 21 të DT ka shënuar:
Sasia e biletave dhe destinacionet mund të ndryshojnë varësisht nga kërkesat dhe nevojat e Autoriteteve Kontraktues dhe biletat kryesisht do të jenë kthyese por mund të këtë kërkesa për bileta një drejtimëshe apo dhe disa drejtime.

Vlera e biletës prej 500 euro është një vlerë që shërben vetëm për kalkulim të çmimit dhe çmimi total do të përdorët vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës pasi që çmimi do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga çmimet që do të procedohen nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILEO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo sisteme online. Kontrata do të bazohet ne sasi.
Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është (+-30%) për Pjese ose pozicion / artikull

Në faqen nr. 42 të DT të Pjesa III- Kontratës - Kushtet e Veçanta, ka shënuar:
Çmimi i biletave krijohet nga çmimi që gjenerohet nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILEO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo çmimet momentale në web faqet e aviokompanive kur është rezervuar bileta plus tarifa e shërbimit (service charge) sipas shumës fikse të ofruar nga kontraktuesi e paraqitur në numrin rendor 2 të Listës së Çmimeve.

Në faqen nr. 43 të DT të Pjesa III- Kontratës - Kushtet e Veçanta, ka shënuar:
Tarifa e shërbimit e shprehur në shumë fikse dhe e paraqitur në numrin rendor 2 të tabelës së çmimeve, gjatë realizimit të kontratës është e pa ndryshuar dhe çdo herë aplikohet në vlerën totale të çmimit variabël të biletës të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit apo çmime të gjeneruar online.
Vlera e biletës prej 500 euro është një vlerë që shërben vetëm për kalkulim të çmimit dhe çmimi total do të përdorët vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës pasi që çmimi do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga çmimet që do të procedohen nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILEO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo sisteme online. Kontrata do të bazohet ne sasi.

Prandaj konstatimi i komisionit të vlerësimit të ofertave së gjate hartimit të listës se çmimeve është lëshuar një gabim kur të çmim për njësi është vendosur çmimi 500 euro ku ne realitet ka qene 495 dhe së gjeja nga ky gabim ka rezultuar së të gjitha ofertat kane tejkaluar vlerën e parashikuar për ketë projekt nuk qëndron për faktin edhe Lista e Çmimeve, Përshkrimi në Lista e Çmimeve, përshkrimi në Aneksin Nr. 1 dhe përshkrimi në Pjesa III- Kontratës - Kushtet e Veçanta, janë hartuar konforme legjislacionit të prokurimit publik ashtu siç e kane bere edhe Autoritetet Kontraktuese tjera që kane publikuar tenderët e tyre për shërbime të transportit ajror e me të cilët kemi nënshkruar kontratat. Gjithashtu duke u bazuar në të gjitha të dhënat që Autoriteti Kontraktues ka shënuar ne Dosje të Tenderit dhe në Listën e Çmimeve shihet së çmimi i planifikuar i biletës **500.00 Euro** dhe çmimi total i planifikuar prej **700,000.00 Euro** nuk përcakton çmimin real të kontratës pasi që çmimi do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga çmimet që do të procedohen nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILEO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo sisteme online dhe së **Kontrata gjate periudhës tri vjeçare konsiderohet e realizuar në bazë të sasive të biletave dhe jo vlerës së biletave ku** sasia e parashikuar prej **1400 bileta është vetëm sasi Indikative.** Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është **(+-30%).**

Prandaj edhe ky fakt dëshmon së gjate realizimit të kontratës mund të ndryshohet vlera e kontratës që sipas ofertës tone është 700,014.00 €, mund të ndryshohet sasia e biletave dhe gjithashtu mund të ndryshohen edhe çmimet e biletave.

Konstatimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se nga lëshimi i gabimit në Listën e Çmimeve asnjë nga OE nuk mund të trajtohet në mënyre të barabartë, **me së buti që mund të thuhet është konstatim jo profesional** për faktin së gjate ofertimit nuk ka pasur asnjë ndikim që Operatoret Ekonomik të mos trajtohen si të barabarte. Ketë e dëshmon fakti së të tre Operatoret Ekonomik që kane ofertuar në ketë aktivitet të prokurimit kane ofertuar me kushte të njëjta, me specifika teknike të njëjta dhe me Liste të Çmimeve të njëjtë. I vetmi dallim është së të dy Operatoret Ekonomik tjerë- OE:" Altavia Travel" SHPK dhe OE: " AIRVOYAGE" SH.P.K nuk kane arritur që të **dorëzojnë oferta të përgjegjshme.**

OE " Altavia Travel" SHPK, nuk e **ka shënuar vlefshmërinë e ofertës** në Formularin e Tenderit edhe pse AK në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate ka kërkuar që vlefshmëria e ofertës të **jete 90 ditë.** Gjithashtu ky OE së bashku me ofertën nuk i ka dorëzuar edhe **dy deklaratat** që AK i ka kerkuar ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate:

c. OE duhet te sjelle deklarate me shkrim ku zotohet se gjate implementimit te kontratës për çdo shërbim ne momentin kur behet shërbimi bileta te përmbaje këto të dhëna.

d. OE duhet te sjelle deklarate me shkrim ku zotohet se gjate implementimit te kontratës për çdo shërbim momenti kur behet shërbimi AK do te njoftohet online përmes sistemeve ku janë
blere biletat.

OE: " AIRVOYAGE" SH.P.K. ka dorëzuar sigurimin e tenderit me afat prej **90 dite** ndërsa ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate është kërkuar afti **120 ditë.** Gjithashtu edhe ky OE së bashku me ofertën nuk i ka dorëzuar edhe **dy deklaratat** që AK i ka kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate:

c. OE duhet te sjelle deklarate me shkrim ku zotohet se gjate implementimit te kontratës për çdo shërbim ne momentin kur behet shërbimi bileta te përmbaje këto të dhëna.

d. OE duhet te sjelle deklarate me shkrim ku zotohet se gjate implementimit te kontratës për çdo shërbim momenti

kur behet shërbimi AK do te njoftohet online përmes sistemeve ku janë blere biletat.

Bazuar në të dhënat e cekura me larte shihet së e vetmja oferte që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate është oferta e kompanisë tone OE: " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K që ka ofertuar më Tarifën e shërbimit (service charge) për një bilete vetëm **0.01 €, (që është e pa ndryshueshme gjate tere periudhës tri vjeçare të realizimit të kontratës.**

I vemi Operator Ekonomik që është diskriminuar në ketë aktivitet të prokurimit është kompania jone: **"AS TRAVEL CLUB " SH.P.K** për faktin së edhe pse i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues, fatkeqësisht AK nuk na ka shpërbluar me kontrate por në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik të aplikueshëm në Republike e Kosovës, konkretisht nenit 62 te LPP dhe nenin 43 te RRPP 002/2024 ka marr vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Ketë veprim të AK ne e konsiderojmë edhe **si favorizim** të dy OE tjerë që kane dërguar të AK oferta të pa përgjegjshme për faktin së AK me anulimin e aktivitetit të prokurimit po i favorizon këta dy OE duke **ju dhëne mundësi që edhe një here të ofertojnë** në aktivitetin e prokurimit që AK pretendon së do ta Ri-tenderoj.

Për kompaninë tone janë shume shqetësues dhe jo profesionale edhe këto veprime të Zyrtareve të Autoritetit Kontraktues- Policisë së Kosovës:
Së pari, në vendimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit datës **10.06.2025** shënon së anulimi është bere në mungese të një oferte të përgjegjshme.
Së dyti shënon se një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor.
Së treti shënon së është vërejtur së në fazën e përgatitjes së specifikimeve teknike janë disa mangësi.
Së katërti shënon së gjate përgatitjes së listës se çmimeve është lëshuar një gabim kur te çmim për njësi është vendosur çmimi 500 euro ku ne realitet ka qene 495 dhe së ky gabim ka rezultuar së te gjitha ofertat kane tejkaluar vlerën e parashikuar për ketë projekt.
Së pesti shënon së nga ky lëshim asnjë nga OE nuk mund të trajtohet në mënyre të barabartë.

Shtrohet pyetja së cila është e vërteta që ka detyruar Zyrtaret e AK që ta anuloj aktivitetin e prokurimit????

Në konsiderojmë së Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë baze ligjore për ta anuluar aktivitetin e prokurimit për faktin së siç e cekem edhe me larte oferta e kompanisë tone: OE: AS TRAVEL CLUB "SH.P.K , është oferta e vetme e përgjegjshme në ketë aktivitet të prokurimit dhe i plotëson të gjitha kërkesat e AK të kërkuara në DT dhe NK dhe së nuk ka ndodhur asnjë shkelje e ligjit aktual që nuk mund te riparohet.

Gjithashtu zyrtaret e AK ketë aktivitet të prokurimit e kane zhvilluar duke përdore afatet e përshpejtuara kohore (emergjente) ndërsa prej datës së hapjes së ofertave deri të përfundimi i vlerësimit të ofertave kane kaluar mbi **25 dite** dhe tani **pas 25 ditëve** në kundërshtim të plote me depozitat e legjislacionit të prokurimit publik, konkretisht në kundërshtim të plote me nenin **62 të LPP dhe nenit 43 të RRPP 002/2024,** marrin vendim **për anulim të aktivitetit të prokurimit**. A nuk është kjo neglizhence e

qëllimshme e prolongimit të realizimit më sukses të këtij aktiviteti të prokurimit?

Prandaj duke u bazuar në faktet dhe argumentet e shënuara me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP – së, që Ankesën tone ta konsideroje si të bazuar, të marre vendim për anulimin e Vendimit të AK të datës 10.06.2025 dhe lenden ta ktheje në Ri-vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Ofertës , shpenzimet e përgatitjes së Kërkesës për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Njoftimi për Kontrate:28.04.2025
2. Procesverbal i Hapjes se Tenderëve: 15.05.2025
3. B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës: 10.06.2025
4. Kërkese për qasje ne Dokumentet e Tenderit:10.06.2025
5. Konfirmimi i Lejimit ne Qasje të dokumenteve të Tenderit: 11.06.2025;
6. Kërkese për Rishqyrtim: 16.06.2025
7. Vendimi i AK- Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 20.06.2025
8. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*